

6166

22.04.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
TRAJTIMI I STUDENTEVE SHA VLORE

Nr. 65/ Prot.

Vlore më, 17/04/2025

Lenda: Informacioni i detajuar mbi detyrimet e prapambetura ne nivel progresiv deri ne dt.31/03/2025 te "Trajtimi i Studentit" Sh.a Vlore

**BASHKISE VLORE
KESHILLI I BASHKISE**

Per dijeni: KESHILLIT MBIKQYRES TE TRAJTIMIT TE STUDENTEVE SHA VLORE

Ne baze te akt rakordimeve me furnitoret , "Per detyrimet e prapambetura ne nivel progresiv,likujdimet e kryera gjate vitit aktual si dhe detyrimet qe mbeten pa likujduar deri ne dt.31/03/2025,paraqesim ne Tab.1. si me poshte .:

N	EMERTIMI	NIPT	DETYRIM I Faturuar Principali	Kamata+ Gjoha	Detyrim TOTAL	Likujdim V.2024 V.2025	DETYRIM deri 31.03.2025
			1	2	1+ 2		
I	DETYRIME AFATGJATA		46 207 937	28 985 656	75 193 593		75 193 593
1	OSHEE VLORE	K72410014H	34 360 389	28 199 564	62 559 953		62 559 953
2	UJESJELLES VLORE	K07303204A	10 335 281	786 092	11 121 373		11 121 373
3	BOLVOIL SH.A FIER	K32528408H	1 512 267	0	1 512 267		1 512 267
II	DET. AFATSHKURTRA		32 170 146	5 365 612	37 535 758	26 771 588	10 764 170
1	BASHKIA VLORE TAKSA VENDORE	<i>Fituar ne Gj. Admin. te Shkalles I. shuhen te gjitha detyrimet e takses se ndërteses + truall te vendosura ndër vite, ne kundërshtim me ligjin.</i>	2 061 389	0	2 061 389	0	2 061 389
2	DEGA E TATIM TAKSAVE	Mars2022- Mars 2025	24 907 001	5 365 612	30 272 613	24 169 880	6 102 733
5	BUJAR RAMI	Auditi PF viti 2021	360 000	0	360 000	360 000	0
6	SHERIFE HOXHA	Auditi PF viti 2021	360 000	0	360 000	360 000	0
7	ELDAR KAZO	Auditi PF viti 2022	360 000	0	360 000	360 000	0
	ARDJOLA HUTA	Auditi PF viti 2022	360 000	0	360 000	360 000	0
8	ARQILE MISHTAKU	END -KEI Audit PF 2023	370 000	0	370 000	370 000	0
9	DRSHTR VLORE	Taksa mjeti viti 2023-2024	38 778	0	38 778	38778	0
10	NISATE+POSTE		163 594	0	91 546	91 546	72 048
11	ARBEN RRAPAJ	TABELE INSTITUCIONI	50 000	0	50 000	50 000	0
12	SIGAL INIQA GROUP	Sig.cgod/makina v.2024	324 568	0	324 568	324 568	0
13	ATLANTIK SHOQ.SIG	Sig.god/makina v.2025	328 832	0	328 832	0	328 832
14	HEP -2012	Detergjente	148 980	0	148 980	0	148 980
15	IGLI PELET	Pelet per ngrohje/larje	624 078	0	624 816	0	624 078
	VENDIM GJYQI Veziko Zepa	Ish punonjese permb.Ylli Hyso	286 816	0	286 816	286 816	0
	VENDIM GJYQI,Teuta Zile	Ish Administratore, Permb.Ylli Hyso	1 426 110	0	1 426 110	0	1 426 110
	SHUMA TOTALE	Detyrime deri 31/03/2025	78 378 083	34 351 268	112 729 351	26 771 588	85 957 763

Trajtimi i Studentit Vlore, monitoron detyrimet ne menyre periodike dhe ne cdo muaj e tremujor informon: Asamblene e Pergjithshme Bashkia Vlore, Drejtorine e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiare ne MAS, per

ecurine ekonomiko-financiare dhe ne vecanti detyrimet e prapambetura si dhe ato te krijuara gjate 3/mujorit te I-re te viti ushtrimor 2025.

Trajtimi i Studentit Vlore me VKM Nr. 349, datë 07/06/2023 "Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sha Vlorë,nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Vlorë, statutit te shoqerise, me cilesine e Aksionarit te Vetem te shoqerise (Pronari i vetem) kaloje me te gjitha Asetet dhe me gjithe Detyrimet ne vleren **86 821 183 leke**.

Masat e ndermarrra:

Masat e mara nga Shoqeria ,Asambleja e Pergjithshme,Keshilli Mbikqyres ,per permiresimin e gjendjes ekonomike financiare , reflektohen qarte ne tab.e mesiperme,ku jane pasqyruar ne menyre analitike ecuria e detyrimeve si dhe likujdimi i tyre gjate gjithe vitit 2024 e ne vazhdim me 3/mujorin e I-re 2025,ku duket ndjeshem ndryshimi:

- Nga 112 729 588 leke (principal +Gjoba+ kamatvonesa) ne progresiv detyrimet mbeten 85 957 763 leke, nga keto:

- **5 365 612 leke** jane Gjoba e Kamat vonesa te detyrimeve per Degen e tatimeve ,per te cilat jemi ne proces me **Apelimi Tataimor** ne zbatim të nenit 4, neni 114/4 të LIGJIT Nr. 124/2012 date 20.12.2012 "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008 "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË,i ndryshuar,ku kërkojmë, heqjen e gjobave dhe kamatvonesave të vendosura elektronikisht në sistemin e tatimeve .

- **2 061 389 leke,Taksa vendore**,jemi ne proces gjyqesor, Fituar ne Gj. Admin. te Shkalles I. shuhet ne te gjitha detyrimet e takses se ndërteses + truall te vendosura ndër vite, ne kundërshtim me ligjin.

-**1 173 938 leke, jane shpenzime operative** te realizuara gjate vit 2024, shume te domosdoshme per sigurine e studenteve, (qe perfshin: siguracionin e godinave, pelet per ngrohje + uje sanitar, detergjent dhe fatura e internetit + posta). Per mungese fondesh shpenzimet jane minimalizuar ne maksimum. Mos realizimi i te gjitha shpenzimeve te domosdoshme operative, ka krijuar mangesi te thella ne mbarevajtjen e punes ne konvikte. **Likujdimi i shpenzimeve operative te prokuruarra, te mesiperme, nuk eshte bere sepse Llogaria bankare e shoqerise eshte e bllokuar** (prej Tetor 2024 e ne vazhdim) nga Drejtoria e Borxhit Fier per detyrimet e sigurimeve shoqerore e shendetsore, te cilat momentalisht jane te likujduara (vetem principali), kane mbetur vetem Gjoba e Kamat vonesa te sqaruara me siper.

- *Ne zbatim te pikes 106,Udhezimit Nr.9.date 20.03.2018"Ne miratimin e fondeve sipas programeve dhe zerave te shpenzimeve me pare ,do te mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i meparshem dhe pastaj fondet per te financuar veprimtarine e vitit ne vazhdim",ne projekt programin e shoqerise per vitin 2024, jane planifikuar dhe detyrimet e prapambetura si ze me vete nga fondet e te ardhurave te shoqerise, fonde shtese nga Ministria e Arsimit dhe Bashkia Vlore ne cdo muaj, perpos subvecionit te permuajshem.*

- **Nga Buxheti i Bashkise i vitit 2024 jane alokuar 15500mije /leke .**

- **Nga Buxheti i Bashkise i vitit 2025 per 3/mujorin e I-re jane alokuar 6 000mije /leke .**

Ky fond u perdor per shlyerjen e Detyrimeve tatimore (sigurime shoqerore e shendetsore te punonjesve)te pa likujduara nga Mars 2022 –Shkurt 2025, shume emergjente per punonjesit.Keto te Fonde u alokuan nepermjet Deges se Thesarit Vlore.

-**Nga te ardhura e shoqerise u likujduan detyrime te prapambetura ne te trete sipas tabelës ne vleren 5 271 588 leke.**

-**Nga MAS per detyrimet e prapambetura e ne vazhdim per vitin 2024, nuk eshte alokuar fond i vecante , ne asnje vit pamvaresisht planifikimit ne buxhet nder vite .**

-**Ne vazhdim detyrimet jane prioriteti kryesor i shoqerise per vitin 2025, shlyerjen ndaj Ujesjellesit dhe FSHU-se .**

Keto Detyrime do te perballohen nga fondet e planifikuara nga Bashkia si dhe nga te ardhura e shoqerise

Problematikat :

Krijimi i ketyre detyrimeve ka lindur nder vite si pasoje e mos zbatimit te Vendimit 75, date 12.02.2018 "Fondet e buxhetit te shtetit ,te miratuara ne forme transferte per "Shoqerite e Trajtimit te Studenteve" , kryhen me urdher te njesise se qeverisjes se pergjithshme dhenese me paraqitjen e dokumentave justifikuese te shpenzimeve (situacion, fatura, listepagesa, etj.)".

Subvecionimi i Trajtimit te Studentit Vlore, nuk eshte kryer asnjehere ne baze te dokumentave justifikuese te derguara bashkelidhur me situacionet mujore.

Masa e subvecionit ne muaj nuk mjafton as per pagat e punonjesve te cilat zevendesohen nga te ardhurat e shoqerise.(psh. Paga neto mujore kap vleren 2 000 000 leke dhe suvecioni mujor eshte ne masen 1 500 000leke).

Masa e subvecionit nuk ndryshon as kur Qeveria ndryshon pagen minimale.

Cdo vit masa e subvecionit ne total sa vjen e ulet nga MAS. duke e cuar shoqerine ne veshtiresi financiare.

Masen e subvencionimit e bejne ne zbatim te Udhezimi nr.7, date 24.04.2003 të Ministrise se Finncave dhe Ministrise se Arsimit "Per kriteret e planifikimit dhe perdorimit te subvecionit buxhetor ne ndermarjet e Trajtimit te studenteve dhe Ndermarjet e Konvikteve dhe mencave te studenteve".

Nga ana jone vazhdimisht eshte kundërshtuar dhe sugjeruar per pavlefshmerine e ketij udhezimi , për arsye se:

- Udhëzimi i lartpërmendur, ka dalë në zbatim të Ligjit nr. 8983, date 20.12.2002"Per buxhetin e shtetit te vitit 2003 dhe udhezimit nr.6, date 30.01.2003" per zbatimin e buxhetit te shtetit per vitin 2003" të cilat jane shfuqizuar ,detyrimisht dhe ky udhezim eshte i shfuqizuar .
- Ky udhezim eshte miratuar kur Trajtimet e studenteve ne vitin 2003, ishin Ndermarje Shteterore ,Sh.a-te u krijuan ne Korrik te viti 2005/mu.
- Nuk pershtaten me kushtet aktuale te zhvillimit ekonomiko – financiar të vendit;
- Nuk pershtatet me ndryshimet e cmimeve (te cilat kane pesuar nje ndryshim total qush nga viti 2003,vite ne te cilin eshte miratuar ky udhezim).
- Nuk pershtatet me tarifat e faturave standarte te shpenzimeve
- Nuk pershtatet me Paktin e Universiteteve ,Vendimit 75, date 12.02.2018, i larte permendur.
- Nuk pershtatet me menyren dhe organizimin e puneve ne shoqerite e trajtimit te studenteve;
- Shërbimi që ofrojnë këto shoqëri janë me pergjegjesi e larte ndaj studenteve në plotesimin e kushteve te jeteses por dhe kujdesit ndaj tyre ne cdo aspekt brenda teritorit te shoqerise.
- Konvikti punon me organizim 3- turne, në të cilën cdo turn ka strukturen sipas pozicioneve, pergjegjesive dhe nevojave.*Për këtë arsye, stafi/punonjësit aktual është i organizuar dhe i përshtatur me 3 turne sipas K.P*
- Shoqëria ka 5 vjet qe projekt programet **miratohen** nga Keshilli Mbikqyres dhe Asambleja e Pergjithshme Ministria e Financave dhe Ekonomise sot Bashkia Vlore (vitet 2019-2025).
- Ministria e Arsimit , ka 5 vjet qe projekt programet (vitet 2019-2025) **nuk i miraton**, per te vetmen arsye na sugjeron te largohen 12 punonjes nga puna .

Largimi nga puna i punonjesve, **e para** bie ndesh me menyren e organizimit real te punes, qellimit kryesor te veprimtarise ne sherbim te akomodimit, te sigurise e pergjegjesise qe kemi ndaj studenteve dhe prinderve per femijet e tyre ne cdo ore te dites.Udhezimi nuk pershtatet me ndryshimet ligjore, per sa me siper spjeguar dhe se **dyti** do te penalizonte rende gjendjen financiare te shoqerise me detyrime gjyqesore.Struktura organike e shoqerise ndryshon e miratohet me KM te shoqerise, sa here qe kemi levizje te fuqise punetore.

Duke ju falënderuar per bashkepunimin!

